

27.01.2022
Ora 16:09

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa), LSI (A.Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Atëherë, në seancën e sotme kemi në rend dite projektvendimin “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të bashkisë të datës 6 Mars 2022”. Projektvendim “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit zgjedhor, të ZAZ-ve nr. 2, 3, 4, 5, 19, 21, 22, 23, 24, 26, 43, 54 dhe 55, për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022” dhe pika e tretë, projektvendimi “Për miratimin e modeleve dhe specifikimeve, shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.

Mirë, atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Projektvendimi “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve”.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**


**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2022**

Z. Y. Merkaj: Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “g” e Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve. Në këtë kuadër kemi përgatitur programin për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022. Programi është detajuar në 10 faqe dhe është i ndarë në 6 pjesë, ku përfshihen zgjedhësit për edukim, informim dhe ndërgjegjësim për kërkimin e emrit në listën e zgjedhësve, procedurat e identifikimit, mënyrën e votimit, veprat penale që prekin zgjedhjet, sensibilizimin e grave dhe të rinjve dhe votuesve për herë të parë si dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit. Të gjitha materialet për ndërgjegjësimin e zgjedhësve, do të përkthehen në gjuhën e pakicave kombëtare, detyrime që burojnë nga ligji për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Programi i edukimit zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e pjesshme, të datës 6 Mars 2022, përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren për realizimin e objektivave. Gjithashtu reflekton punën dhe angazhimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për edukimin zgjedhor të shtetasve, në përmbushje të detyrës institucionale për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara ku edukimi dhe informimi i zgjedhësve është ndër komponentët kryesorë garues për arritjen e standardeve të synuara. Programet informuese do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit të KQZ-së me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë. Ky program përmban 6 objektiva kryesore, të ndara si më poshtë:

Në pjesën e parë është informimi dhe edukimi për sensibilizimin e zgjedhësve që të kontrollojnë emrin në listë.

Pjesa e dytë është informimi dhe edukimi i zgjedhësve për procedurat e identifikimit elektronik në ditën e zgjedhjeve.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2022**

Pjesa e tretë është informimi dhe edukimi i zgjedhësve për mënyrën e votimit dhe përmbajtjen e fletës së votimit.

Pjesa e katërt është sensibilizimi i grupeve vulnerabël dhe votuesve për herë të parë.

Pjesa e pestë është sensibilizimi i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor dhe,

pjesa e gjashtë është ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe rritja e pjesëmarrësve të tyre në votime. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe programet e edukimit, bashkëlidhur këtij vendimi, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, në lidhje me projektaktin në parim, jeni dakord besoj?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në parim zoti Komisioner nuk kemi ndonjë gjë, jemi dakord!

Z. I. Celibashi: Për përmbajtjen e aktit?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dakord!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë, miratohet projektvendimi, sipas draftit të paraqitur. Me këtë rast rrjedhimisht miratohet dhe programi i edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit që do të aplikojë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë, të datës 6 Mars 2022.

Vendimi nr. 24

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



27.01.2022
Ora 16:13

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor të ZAZ-ve nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 19, nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 26, nr. 43, nr. 54, nr. 55 për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa), LSI (A.Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë me ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor, për KZAZ-të e bashkive ku do të zhvillohen këto zgjedhje.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 28 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 5 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve merr vendim për përgatitjen e KZAZ-ve, jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit. Në mbledhjen e djeshme u emëruan anëtarët e 13-të KZAZ-ve për zgjedhjet vendore të datës 6 Mars 2022, dhe referuar Kodit Zgjedhor duhet të caktohet mbledhja e parë, e cila thirret të bëhet me vendim nga Komisioneri

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2022*

Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe është mbledhja e konstituimit të KZAZ-ve. Duke parë dhe kohën e shkurtër, kemi menduar dhe propozuar Komisionerit Shtetëror, që mbledhja e parë të zhvillohet nesër, në datën 28 janar 2022, në selitë e përcaktuara sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Orari i zhvillimit të mbledhjes së parë duhet të jetë nga ora 10:00 – 17:00, meqenëse në një zonë zgjedhore janë katër KZAZ, kështu që inspektorët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të jenë të angazhuar në komisione të ndryshme dhe do t'iu duhet koha më e gjatë për të asistuar në mbledhjen e parë të KZAZ-ve, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, në parim me projektaktin?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në parim dakord, zoti Komisioner! Nuk kemi ndonjë gjë!

Z. I. Celibashi: Për përmbajtjen?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Edhe për përmbajtjen dakord! Vetëm një kërkesë do të kisha për komisionin. Duke pasur në konsideratë edhe kohën kur zhvillohen këto zgjedhje, si dhe faktin që këto janë ambiente të mëdha duhet t'u krijojmë dhe kushte komisionerëve, kushte normale pune për ngrohje dhe për asistencë, sepse normalisht do të jenë goxha temperatura të ftohta.

Z. I. Celibashi: Po, në fakt duhet parë edhe kjo çështje, duhet konsideruar se tej atyre masave që kemi marrë për pajisjen me mjetet e punës, dokumentacionin e punës, do parë dhe kjo çështje. Po, dakord! Do komunikuar me kryetarët e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2022*

bashkive në detyrë, se në fakt në këto bashki zgjedhjet për kryetarë të bashkisë bëhen, ose dhe me autoritete të tjera vendore për ta zgjidhur këtë. Mirë dakord, atëherë, miratojmë projektvendimin, sipas draftit të paraqitur. Mbledhja e parë do të zhvillohet nesër, në datën 28. Besoj janë marrë masat për të bërë njoftimet, do të ketë përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në momentin e parë të konstituimit të këtyre organeve. Tashmë e kemi këtë traditë, kështu që nuk besoj se do të ketë probleme.

Vendimi nr. 25

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**27.01.2022
Ora 16:16**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e modeleve dhe specifikimeve të shenjave dalluese të logjistikës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa), LSI (A.Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës. Projektvendimi për miratimin e modeleve dhe specifikimeve, shenjat dalluese të logjistikës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të bashkisë, të datës 6 Mars 2022. Po, zoti Sekretar!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 99, pika 2, shkronja “dh” e Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në selitë e KZAZ-ve për çdo qendër votimi materialet zgjedhore, si dhe mjetet e tjera të nevojshme për procesin e votimit, siç janë shenjat dalluese, mjetet e identifikimit, modelet e etiketës së kutisë së votimit dhe kutisë së materialeve të votimit dhe vendosjen e shenjave dalluese në hyrje të ndërtesave, ku ndodhet selia e KZAZ-ve, qendrat e votimit dhe vendi i numërimit të votave. Gjithashtu mjeti i identifikimit të komisionerit zgjedhor, me

**Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2022*

të dhënat e komisionit dhe funksionit përkatës që do të mbahet gjatë ushtrimit të detyrës si etiketë dhe transparencën për komisionerin zgjedhor që do të dëshmojë gjatë ofrimit të shërbimit për zgjedhësit dhe vëzhguesit. Referuar nenit 99, siç e thashë dhe më lart, kemi përgatitur modelet e shenjave dalluese, të cilat sipas këtij neni miratohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe shenjat dalluese që janë bashkëlidhur këtij vendimi, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Parimisht dakord, zoti Komisioner! Jemi dakord edhe me shenjat dalluese sepse kemi dhe një eksperiencë nga zgjedhjet e mëparshme, normalisht ka krijuar eksperiencë dhe besoj që edhe anëtarët e KZAZ-ve janë po të njëjtët dhe kanë eksperiencë. Vetëm një kërkesë kisha më specifike, e kam dhe nga eksperiencia personale, sepse jam marrë realisht kam qenë pjesë e KZAZ-ve dhe e di rrëmujën që ndodh aty brenda. Inspektorët e KQZ-së në momentin që do shkojnë që të bëjnë dhe mbledhjen e parë, të bëjnë një trajnim me anëtarët e KZAZ-ve, në lidhje me tabelat dhe mbivendosjen e tyre, sepse krijohet një amulli dhe kemi pasur dhe probleme në zgjedhjet e kaluara. Duhet të përcaktojnë qartë se ku vendosen tabelat, si dhe zarfet të jenë të përcaktuara qartë.

Z. I. Celibashi: Shënoje!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Kur të vijë dhe momenti që do të ndahen zarfet e pavlefshme nga të vlefshmet, sepse në zgjedhjet e kaluara kishim disa lloj

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.27.01.2022*

modelesh fletësh votimi, këto janë më të thjeshta normalisht, por bëhej një amulli në lidhje me tabelat, me zarfet, me formularët.

Z. I. Celibashi: Dakord!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Mendoj që duhet një trajnim më specifik edhe më i gjatë, në këtë pjesë. Ato ishin zgjedhje më voluminoze, kishte më shumë problematika, por përsëri në qoftë se është e mundur, t'i japim mundësi edhe KZAZ-ve që të jenë sa më efektive dhe më cilësore në veprimtarinë e tyre.

Z. I. Celibashi: Po, edhe pse koha është e shkurtër, po për shkak të natyrës së thjeshtë të zgjedhjeve të themi, mund të kemi mundësi më të mëdha për t'i sqaruar më mirë disa çështje. Dakord! Mirë, atëherë e miratojmë dhe këtë projektakt sipas draftit të paraqitur. Çështje të tjera për shqyrtim në rendin e ditës, nuk kemi?

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk kemi!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Seanca mbyllet!

Vendimi nr. 26

*Zbardhi materialin audio
Merita Dulaku*

